

FJALA E DEPUTETIT TONI GOGU

E ENJTE 15 SHTATOR 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Duhet thënë që në fillim se kjo marrëveshje partneriteti midis Komisionit Europian, Bashkimit Europian dhe Shqipërisë, që ne miratojmë sot, pavarësisht teknikaliteteve, është një mekanizëm dhe një instrument që financon ribashkimin e Shqipërisë me kontinentin e saj, me kulturën europiane, me historinë dhe me sfidat europiane. Ky instrument është pjesë e një mekanizmi të madh, që Bashkimi Europian miratoi për të qëndruar së bashku. Ky instrument, të cilin ne e miratojmë sot, financon të ardhmen tonë të përbashkët europiane. Prandaj miratimi i këtij instrumenti, i kësaj marrëveshjeje ka një rëndësi të paimagjinueshme sot, pavarësisht diskutimeve të vogla që bëjmë për të kuptuar ndryshimin se si mund t'i qasemi zbatimit dhe miratimit të këtij instrumenti.

Farkëtuam një instrument me një potencial shumë të madh, do të thoshte Komisioneri Borrell-i, i cili sinjalizoi mbështetjen e palëkundur të Bashkimit Europian ndaj rajonit që po zgjerohet. Bëhet fjalë për Ballkanin Perëndimor dhe janë 15 miliardë euro me vlerën e sotme të euros, pasi, në varësi të kursit të këmbimit, ajo vlerë rritet, të cilat tregojnë qartë se ky është instrumenti i investimit për të ardhmen europiane të rajonit tonë. Ndaj, dua të them se është një shans i paimagjinueshëm për të thelluar reformat europiane në vendin tonë; është një shans i paimagjinueshëm që drejtësia të bëhet e barabartë për të gjithë dhe jo vetëm për ata që kanë pushtet dhe para, por që kanë filluar ta kuptojnë se po u afrohet, po u vjen dita e drejtësisë.

Kjo marrëveshje mundëson thellimin e reformave në arsim, pasi u jep mundësi universiteteve tona të aplikojnë edhe në instrumente të reja, siç është Horizon apo Erasmus+, si dhe të gjithë

studentëve, pavarësisht prejardhjes, origjinës, por vetëm për shkak të punës së tyre, të mundet të shkëmbejnë informacionet, njohuritë me universitetet dhe me bashkëmoshatarët e tyre europianë. Kjo marrëveshje thëllon reformën që kemi nisur dhe po zbatojmë në sektorin energjetik që jo vetëm energjia të jetë e bollshme për të gjithë qytetarët tanë, por të mundet ta kemi atë edhe për fqinjët. Kështu që, pa humbur kohë, do të doja t'i mbështesja ata kolegë që thanë sfidat për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, sepse besoj se për miratimin e saj sot do të bëhemi të gjithë bashkë.

Sfida e parë është fuqizimi i përthithjes së fondeve. Janë 14 miliardë në rajon, ku Shqipëria mundet të konkurrojë. Për këtë arsye janë disa parakushte që përmbush çdo vend. Parakushti i parë: është bërë një punë e paimagjinueshme për sa i përket stabilitetit makro-financiar, pra një vend që të mundet t'i përthithë fondet e vëna në dispozicion, duhet të ketë një stabilitet makro-financiar dhe vetëm qorrat nuk mundet ta shikojnë sfidën ekonomike që ka sot jo vetëm vendi ynë, por i gjithë globi. Ndaj, të gjitha përpjekjet dhe puna e madhe, e cila është bërë gjatë të gjitha krizave që kemi kaluar, qoftë ajo e rindërtimit, qoftë ajo pandemisë, qoftë kriza energjetike që ka përfshirë vendin, duke ofruar mburojë dhe duke forcuar rezistencën sociale qoftë për shtresat në nevojë, por edhe për sektorët strategjikë të ekonomisë sonë, tregojnë se qeveria ka bërë maksimumin për të siguruar parakushtin e parë me të gjitha institucionet e tjera të pavarura, duke pasur parasysh Bankën e Shqipërisë apo Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Një parakusht tjetër është ai i bashkëfinancimit. Zëvendëskryeministrja e përmendi që tashmë në buxhet janë vendosur fondet e duhura për t'i bashkëfinancuar këto projekte, për të përfituar edhe nga ato projekte, të cilat janë ndërkufitare. Ndërkohë që sfida e tretë është ajo, për të cilën kemi folur deri tani: forcimi i kapacitetit administrativ, fuqizimi qoftë i kërkesës, qoftë i ofertës, qoftë i gjenerimit të projekteve, por qoftë edhe i zbatimit të tyre. Ndaj sot ka një koordinator kombëtar për marrëveshjen IPA; ka grupe sektoriale, të cilat tashmë kanë filluar punën për të parashtruar, për të hequr të gjitha burokracitë që kanë qenë aty më përpara, në mënyrë që projektet të fillojnë të vihen në vend. Vetëm vitin e kaluar kam përshtypjen që,

përmes punës së zyrës së koordinatorit kombëtar, ne mundëm të futnim edhe 2 milionë të tjerë.

Nga IPA II vazhdojmë të përthithim, ndërkohë që nga IPA I nuk kemi mundur dot, është mbyllur historia e saj. Për të konkluduar, të nderuar kolegë, kjo marrëveshje nuk mbërriti nga zyra e një burokrati europian të Komisionit Europian në tavolinat tona, thjesht me një e-mail. Të mos harrojmë që BE-ja ka kaluar një sërë krizash vullneti për ta sjellë këtë marrëveshje. Vullneti për t'u ofruar Shqipërisë dhe Ballkanit Perëndimor mundësinë për t'u anëtarësuar ka kaluar në një sërë sfidash. Të mos harrojmë krizën financiare ekonomike të viteve 2008-2010; të mos harrojmë krizën migratore të viteve 2015-2016; të mos harrojmë pandeminë 2020-2021; të mos harrojmë krizën e Ukrainës që jemi duke e kaluar sot.

Ndaj, të nderuar kolegë, ne sot kemi vetëm një zgjedhje: sot duhet të bashkohemi të gjithë së bashku për të miratuar financimin e të ardhmes europiane të fëmijëve tanë dhe duhet të heqim dorë nga kriptoputinizmi, i cili financon mbi tavolinë dhe nën tavolinë përpjekje që minojnë haptazi rendin tonë shoqëror, përpjekje, të cilat, në mes të ditës, janë duke bërë të gjitha planet për ta ngrirë kontinentin europian dhe bashkë me ngrirjen e këtij të fundit, të ngrijnë edhe instrumente të tilla dhe natën përpiqen të tollovisin të ardhmen europiane të fëmijëve tanë në vendin tonë qoftë përmes atyre përpjekjeve, të cilat ne i shikojmë dhe janë në mes të mexhllisit, por qoftë edhe të atyre përpjekjeve që tashmë sot janë të fshehura, por që një ditë shumë shpejt do të dalin në dritë dhe do të bëhen të ditura nga të gjithë.

Ndaj, të gjithë ata kolegë, që jam i bindur, pavarësisht se ku janë ulur sot, u dhëmb e ardhmja europiane e fëmijëve të tyre, i ftoj të bëhen pjesë e miratimit të marrëveshjes, të mbështesim përpjekjet e qeverisë në punën e saj dhe koordinatorin kombëtar. Faleminderit!